

KOSOVA ENDE PA EMËR PËR PRESIDENT, RREZIK PËR ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME



Kanë mbetur edhe dy ditë para skadimit të afatit kushtetues për zgjedhjen e presidentes/it. Deri më tani nuk ka marrëveshje ndërmjet partive politike parlamentare për një emër konsensual për president të Kosovës, ndonëse janë dy ditët e fundit

sipas afatit kushtetues kur vendi duhet të ketë president të zgjedhur. Në të kundërtën, automatikisht sipas Kushtetutës, Kosova shkon sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare

AKTUALE



KONFLIKTI IZRAEL - SHBA KUNDËR IRANIT, ÇFARË DO TË THOTË PËR KOSOVËN DHE BALLKANIN?

F. 3

MINISTRI HOTI MERR VENDIM PËR THEMELIMIN E KATËR KOMISIONEVE

F. 6

BE-ja DO TË VAZHDOJË TË MBËSHTESË REFORMËN GJYQËSORE

F. 7

EKONOMI



BE-ja I KA DHËNË 300 MILIONË EURO KOSOVËS VETËM NË GRANTE NGA WBIF

F. 8

BQK-ja FORCON RRUGËN E SAJ DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

F. 8



NGA LINDJA E MESME DERI NË KOSOVË: SI U BË BONDSTEEL TEMË PAS NGJARJEVE NË IRAN?

F. 7



KOSOVA NË VALËN E SHTRENJTIMIT GLOBAL TË KARBURANTEVE

F. 3

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht –Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Buniamini

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

TRUMPI: MBROJTJA DHE UDHËHEQJA E IRANIT JANË SHKATËRRUAR

WASHINGTON, 3 MARS - Raportimet nga Irani kanë bërë me dije se të martën avionë luftarakë amerikanë dhe izraelitë kanë ndërmarrë sulme të reja ndaj një sërë objektiv ushtarake dhe të sigurisë në disa qytete të vendit. Sipas burimeve, në shënjestër kanë qenë selia e Inteligjencës së Gardës Revolucionare (IRGC) në Urmia, Gjykata Revolucionare dhe Publike në këtë qytet, baza “Unity” e IRGC-së në Paveh, si dhe i ashtuquajti “qyteti i raketave” në Najafabad, në veri të provincës së Isfahanit. Ndërkohë, raportohet për fluturime të vazhdueshme të avionëve luftarakë edhe mbi zona të ndryshme të Teheranit, Shirazit dhe Isfahanit. Organizata iraniane, Gjysmëhëna e Kuqe, tha më 3 mars se numri i të vdekurve nga sulmet izraelite dhe amerikane ndaj Iranit, ka arritur në 787. Kjo organizata, që vepron nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Republikës Islamike, tha gjithashtu se 153 qarqe në të gjithë Iranin janë prekur nga sulmet. Gjysmëhëna e Kuqe publikoi shifrat e viktimave pa dhënë detaje ose ndonjë analizë më të detajuar. Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka shkruar në rrjetin Truth Social se “mbrojtja ajrore, Forcat Ajrore, Marina dhe udhëheqja janë shkatërruar”, duke iu referuar kështu situatës në Iran, pas sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit. “Ata duan të flasin. Unë thashë tepër vonë”, ka shkruar Trump. Ushtria izraelite ka njoftuar të martën se forcat ajrore kanë goditur kompleksin e udhëheqjes së regjimit iranian, përfshirë Zyrën Presidenciale dhe Këshillin e Lartë të Sigurisë Kombëtare. Në një deklaratë në Telegram, Forcat e Mbrojtjes së Izraelit thanë se mbi objektiva është hedhur “një numër i madh municionesh”, duke shtuar se është goditur edhe një institucion trajnimi ushtarak, si dhe “infrastrukturë tjetër e rëndësishme e regjimit”. Kompleksi është përdorur edhe nga ish-udhëheqësi suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, sipas njoftimit. Khamenei u vra në kompleksin e tij në fundjavë. Operacioni i përbashkët i ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit, i koduar Tërbimi Epik, është tashmë në ditën e katërt. Presidenti amerikan, Donald Trump, ka thënë se qëllim i operacionit është të “sigurojë që Irani të mos pajiset me armë

bërthamore” dhe i ka kërkuar popullit iranian ta përmbysë regjimin klerik. Operacioni - në të cilin është vrarë edhe udhëheqësi suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei - ka pasuar javë të tëra kërcënimesh nga Trumpi se do të urdhërojë veprime ushtarake, nëse Irani nuk bie dakord për një marrëveshje të re për programin e tij bërthamor. Irani këmbëngul se aktiviteti i tij bërthamor është tërësisht paqësor. Irani është përgjigjur duke lëshuar raketa dhe dronë në të gjithë rajonin, ndërsa grupi militant shiit, Hezbollah - me bazë në Liban dhe i mbështetur nga Irani - u është bashkuar luftimeve, duke lëshuar raketa në Izrael nga bazat e tij.

Trumpi kritikon Britaninë për mospjesëmarrje në sulmet ndaj Iranit

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kritikoi Mbretërinë e Bashkuar, duke thënë se marrëdhënia midis dy vendeve “nuk është si më parë”. Duke komentuar vendimin e Britanisë për të mos marrë pjesë në sulmet e para izraelite dhe amerikane ndaj Iranit, Trump i tha gazetës The Sun se Amerika nuk ka nevojë për Britaninë për të kryer operacione ushtarake në Lindjen e Mesme, por shtoi se kryeministri i këtij vendi, Keir Starmer, “nuk ka qenë i dobishëm”. Ai gjithashtu lavdëroi Francën dhe Gjermaninë si aleate, duke thënë se “tani kemi marrëdhënie shumë të forta me vendet e tjera në Evropë”. Starmer tha më 1 mars se do t'i lejojë Shtetet e Bashkuara që t'i shfrytëzojnë bazat ushtarake britanike për sulme mbrojtëse. Megjithatë, këto baza nuk u përdorën në sulmet fillestare ndaj Iranit, që nisën më 28 shkurt.



Ministri britanik për Marrëdhëniet Ndërqeveritare, Darren Jones, tha se Londra preferon të veprojë në situata të tilla vetëm kur është e koordinuar me partnerët ndërkombëtarë dhe kur ekziston një bazë e qartë ligjore për veprim. Starmer tha më 2 mars se Trump ka kundërshtuar vendimin e Britanisë për të mos marrë pjesë në sulmet e para, por “detyra ime është të vendos se çfarë është në interesin kombëtar të Britanisë”. Ndërkaq çmimet e gazit natyror vazhdojnë të rriten ndjeshëm, ndërsa konflikti në Lindjen e Mesme përshkallëzohet. Sipas raportimeve të publikuara sot, çmimi referencë i gazit në Evropë është rritur për 33%. Kjo lëvizje vjen pas një rritjeje tjetër prej rreth 50% të hënën. Po atë ditë, kompania qeveritare e Katarit, QatarEnergy - një nga eksportuesit më të mëdhenj të gazit në botë - ndaloi prodhimin pas “sulmeve ushtarake” ndaj objekteve të saj. Kurse kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, i hodhi poshtë shqetësimet në lidhje

Kush mund ta udhëheqë Iranin?

Ndërsa Irani përballlet me pasojat e sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit, që kanë vrarë disa - e ndoshta edhe dhjetëra - udhëheqës të lartë, Ali Larijani shfaqet si figurë kryesore në pushtetin e mbetur të vendit. Politikan veteran, me një karrierë që përfshin pothuajse gjithë historinë e Republikës Islamike, Larijani u rikthye vitin e kaluar, pas një pushimi relativ, dhe që atëherë, ka një rol gjithnjë e më të rëndësishëm.

me një konflikt të zgjatur në Lindjen e Mesme. “Dëgjoj që njerëzit thonë se do të kemi një luftë të pafundme këtu. Nuk do të keni një luftë të pafundme”, tha Netanyahu për Fox News. “Ky do të jetë një aksion i shpejtë dhe vendimtar, dhe ne do t'i krijojmë kushtet që populli iranian të marrë kontrollin e fatit të tij, për të formuar qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike”, shtoi ai.

Shqipëria paralajmëron qytetarët të shmangin udhëtimet drejt Lindjes së Mesme

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë përditësoi njoftimin për situatën në Lindjen e Mesme, duke theksuar se, për shkak të përshkallëzimit ushtarak në rajon, gjendja e sigurisë mbetet e paqëndrueshme dhe e paparashikueshme. Autoritetet shqiptare këshillojnë shtetasit të shmangin çdo udhëtim drejt vendeve të rajonit deri në një njoftim të dytë. Ndërkohë, qytetarët që ndodhen aktualisht atje, duhet të tregojnë vigjilencë maksimale dhe të shqyrtojnë mundësinë e largimit përmes linjave ajrore, për aq kohë sa ato vijnë të jenë funksionale. Ministria u bën thirrje qytetarëve të ndjekin vetëm

burime zyrtare dhe mediatike të besueshme, të respektojnë udhëzimet e autoriteteve lokale, të mbajnë dokumentet e udhëtimit dhe mjetet e komunikimit të gatshme, si dhe të kontaktojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare në rast nevojë. Ajo paralajmëron gjithashtu se, në rast të përkeqësimit të mëtejshëm të situatës, mbyllja e hapësirës ajrore në një perimetër më të gjerë mbetet mundësi reale, ndërsa fluturimet mund të anulohen pa paralajmërim.

Katari mbulon shpenzimet e hotelit për turistët e bllokuar, njofton Ambasada e Kosovës në Doha

Ambasada e Republikës së Kosovës në Doha njoftoi se autoritetet e Katarit do t'i mbulojnë shpenzimet e akomodimit në hotel për turistët e bllokuar, që nuk mund të largohen nga ky vend, për shkak të kufizimeve të përkohshme të udhëtimit. Vendimi ka hyrë në fuqi më 28 shkurt dhe do të zbatohet deri në rifillimin e operacioneve në aeroport dhe rihapjen e hapësirës ajrore. Ambasada u bën thirrje qytetarëve të qëndrojnë të qetë dhe t'i respektojnë udhëzimet e autoriteteve vendase.

KONFLIKTI IZRAEL - SHBA KUNDËR IRANIT, ÇFARË DO TË THOTË PËR KOSOVËN DHE BALLKANIN?

PRISHTINË, 3 MARS - Drejtori i Institutit për Studime të Luftës Hibride “OCTOPUS”, Arben Fetoshi, ka komentuar konfliktin aktual mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Izraelit kundër Iranit, si dhe pasojat e tij për sigurinë në Ballkan dhe Kosovë.

Fetoshi në një prononcim për Telegrafin ka theksuar rëndësinë strategjike të Lindjes së Mesme si qendër energjetike dhe nyje tregtare.

Ai tha se operacioni izraelito-amerikan është ndërveprim strategjik për neutralizimin e rrezikut të programit bërthamor, si parakusht për paqen e qëndrueshme. “Duke pasur parasysh rëndësinë e Lindjes së Mesme si potencial energjetik dhe ‘udhëkryq’ i tregtisë botërore, përshkallëzimi rajonal dhe kohëzgjatja e këtij konflikti do të ishte me pasoja serioze për njerëzit, sigurinë dhe ekonominë globale. Goditja

ushtarake ndaj regjimit iranian dhe kërcënimit që paraqet ai me programin bërthamor, ishte veprim i domosdoshëm për disa arsye: e para, sepse armatosja bërthamore e Iranit do ta rrezikonte drejtpërdrejt Izraelin dhe interesat amerikane në rajon; e dyta, sepse vazhdimi i ‘negociatave’ ishte blerje kohe dhe do ta rrezikonte “ekuilibrin e forcave”, dhe e treta, sepse një fuqizim i tillë i Iranit do të ishte “karburanti” më sfidues për boshtin revizionist ruso-kinez.

Prandaj, operacioni izraelito-amerikan është ndërveprim strategjik për neutralizimin e këtij rreziku, si parakusht për paqen e qëndrueshme”, ka thënë Fetoshi.

Por i pyetur se çfarë implikimesh mund të ketë konflikti Iran - ShBA - Izrael për sigurinë në Ballkan dhe, konkretisht për situatën në Kosovë, ai tha: “Siguria në Ballkan vazhdon të jetë e kërcënuar nga ambiciet



ekspansioniste të Serbisë dhe rreshtimi i saj gjeopolitik me Rusinë, Kinën dhe Iranin. Bazuar në reagimet e Aleksandër Vuçiqit, i cili e krahasoi operacionin me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë dhe përvojën e agresionit të vazhdueshëm përmes propagandës e sulmeve terroriste, konflikti në Lindje të Mesme mund ta ‘trimërojë’ Serbinë si me rastin e Ukrainës”. Prandaj, siç u shpreh Fetoshi

ruajtja e vëmendjes ndërkombëtare me KFOR-in dhe angazhimin politik në Ballkanin Perëndimor është me rëndësi përcaktuese. “Nga ana tjetër, për shkak të rëndësisë ekonomike të Lindjes së Mesme, konflikti me Iranin mund të shkaktojë valë të re inflacioni dhe ngritje të çmimeve, por kjo mendoj se do të varet nga dinamika e zhvillimeve dhe kohëzgjatja e konfliktit”, ka thënë Fetoshi.

Fetoshi përjashton rrezikun ushtarak të drejtpërdrejtë për Kosovën për shkak të mbrojtjes nga NATO, por jo edhe tensionet, provokimet apo fushatat dezinformuese me qëllim të destabilizimit. “Mjafton të shohim propagandën e intensifikuar ditëve të fundit për “rrezikun” ndaj Serbisë nga aleanca ushtarake ndërmjet Kosovës, Shqipërisë e Kroacisë dhe “kërcënimin e popullit serb” nga ligji për të huajt apo integrimi i strukturave të arsimit e shëndetësisë në sistemin e Kosovës, që ta parashikojmë qasjen në vazhdim. Prandaj, në raport me implikimet eventuale të konfliktit në Lindje të Mesme, Kosova duhet t’i kushtojë vëmendje maksimale koordinimit me partnerët strategjikë, masave kundër dezinformimit, sulmeve potenciale kibernetike dhe rrjeteve të ndikimit financiar”, tha ndër të tjera Fetoshi.

KOSOVA NË VALËN E SHTRENJTIMIT GLOBAL TË KARBURANTEVE

PRISHTINË, 3 MARS - Brenda vetëm 24 orësh, çmimi i derivateve në Kosovë u rrit për së paku 14 centë. Më 3 mars, një litër naftë në disa pika karburanti arriti në 1.39 euro, ndërsa benzina në 1.38 euro.

Një ditë më parë, çmimet ishin deri në 1.25 euro për naftë dhe 1.24 euro për benzinë.

Lëvizja e shpejtë e tregut vendor nuk është rastësi - ajo pasqyron përshkallëzimin e tensioneve në Lindjen e Mesme dhe tronditjen e zinxhirit global të furnizimit me energji.

Rritja u nxit nga tensionet mes ShBA-së, Izraelit dhe Iranit, që shtynë çmimin e naftës Brent - standardi global i referencës - të rritet deri në 10 për qind më 1 mars.

Pasiguria për ndërprerje të furnizimeve u shtua veçanërisht pas pezullimit të një pjese të dërgesave përmes Ngushticës së Hormuzit.

Kjo ngushticë, përmes së cilës

kalon mbi një e pesta e furnizimeve ditore globale me naftë, shërben si arterie eksporti për vende si Irani, Arabia Saudite, Kuvajti dhe Iraku.

Çdo rrezik për bllokim apo kufizim të qarkullimit përkthehet menjëherë në rritje të kostove të sigurimit dhe transportit dhe, për rrjedhojë, në çmime më të larta në tregjet botërore.

Kosova nuk ka rafineri të saj dhe furnizohet tërësisht nga importet. Vetëm gjatë vitit të kaluar, vendi importoi mbi 478 milionë euro naftë dhe më shumë se 51 milionë euro benzinë.

Furnizimet kryesore vijnë nga Gjermania, Hungaria, Greqia, Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, ndërsa një pjesë e konsiderueshme hyn përmes terminalit të Porto Romanos në Durrës.

Kjo varësi strukturore e bën tregun vendor jashtëzakonisht të ndjeshëm ndaj lëkundjeve



globale.

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, thotë për Radion Evropa e Lirë se çmimet mund të vazhdojnë të lëvizin, pasi kompanitë furnizohen sipas çmimeve aktuale të bursës dhe nuk mbajnë rezerva të mëdha.

Ai shton se nuk ka vend për panik dhe se nuk priten mungesa në

treg, por thekson se dinamika e çmimeve mbetet e varur nga zhvillimet ndërkombëtare.

Përballë rritjes së shpejtë të çmimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e Kosovës njoftoi për një intensifikim të inspektimeve dhe përgatitje të raporteve ditore mbi çmimet.

Sipas ministrisë, në rast të rritjeve

të pajustificuara mund të aplikohen masa mbrojtëse dhe rregullim i përkohshëm i çmimeve, me mbikëqyrje nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore.

Ish-drejtori i Doganës së Kosovës, Naim Huruglica, thotë për Radion Evropa e Lirë se autoritetet duhet të shqyrtojnë vazhdimin e masave mbrojtëse, për të garantuar konkurrencë të drejtë dhe mbrojtje të konsumatorit në kohë krize.

Në situata krizash, paralajmërojnë njohësit e tregut, hapet edhe dera për abuzime.

Eksperti i tregut të naftës, Jakup Gashi, thotë për Radion Evropa e Lirë se ekziston rreziku që kompanitë t’i rrisin çmimet edhe për sasi të blera më herët me çmime më të ulëta.

Sipas tij, inspektorati duhet të verifikojë kohën e importit dhe koston reale për të shmangur abuzimet.

MPJD THOTË SE NUK KA SHTETAS TË KOSOVËS TË LËNDUAR NGA LUFTIMET NË LINDJEN E MESME

PRISHTINË, 3 MARS - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës njoftoi se qindra shtetas të Kosovës ndodhen në disa shtete të Lindjes së Mesme, por asnjëri prej tyre nuk është prekur nga luftimet e ditëve të fundit mes Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara kundër Iranit.

Në një postim në Facebook, Ministria tha se 21 qytetarë të



Kosovës ndodhen në Izrael, 331 në Arabinë Saudite, rreth 400 qytetarë rezidentë dhe 70 turistë të lajmëruar deri tani në

Emiratet e Bashkuara Arabe, 75 qytetarë në Katar, përafërsisht 60 qytetarë në Kuvajt, 4 qytetarë në Bahrein dhe 2 qytetarë në Oman.

“Sipas informacioneve nga misionet tona diplomatike, të gjithë qytetarët tanë aktualisht janë në gjendje të mire shëndetësore”, thuhet në njoftim.

MPJD-ja u bëri thirrje shtetasve të Kosovës në këto vende të

qëndrojnë të qetë dhe të ndjekin me përpikëri udhëzimet e autoriteteve lokale, të shmangin lëvizjet e panevojshme deri në njoftim të radhës dhe të qëndrojnë në kontakt të rregullt me përfaqësitë diplomatike të Kosovës.

Ministria gjithashtu postoi kontaktet ku kosovarët mund të thërrasin për çdo nevojë

urgjente.

Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën një operacion të madh në Iran, më 28 shkurt, duke sulmuar caqet e ushtrisë dhe të regjimit klerik.

Presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë se qëllimi i operacionit, të koduar Tërbimi Epik, është të “sigurojë që Irani të mos pajiset me armë bërthamore”.



KOSOVA ENDE PA EMËR PËR PRESIDENT, RREZIK PËR ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME

Kanë mbetur edhe dy ditë para skadimit të afatit kushtetues për zgjedhjen e presidentes/it. Deri më tani nuk ka marrëveshje ndërmjet partive politike parlamentare për një emër konsensual për president të Kosovës, ndonëse janë dy ditët e fundit sipas afatit kushtetues kur vendi duhet të ketë president të zgjedhur. Në të kundërtën, automatikisht sipas Kushtetutës, Kosova shkon sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 3 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka takuar sërish të martën kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, në lidhje me zgjedhjen e presidentit të ri. Pas këtij takimi, Kurti ka thënë se ende nuk ka zgjidhje. "Takimi shkojë në atmosferë konstruktive, mirëpo kur ka diçka të re do t'ju njoftojmë. Ende nuk i kemi zgjidhjet, mirëpo do të ju njoftojmë së shpejti", ka thënë shkurt Kurti. Pas takimit Kurti-Abdixhiku menjëherë është mbledhur grupi parlamentar i LDK-së. Pas një orë diskutim për medie ka folur deputeti i LDK-së, Besian Mustafa, i cili ka theksuar se e ende nuk ka marrëveshje për ndonjë kandidat për postin e

presidentit.

Ai vlerësoi se zgjedhjet e parakohshme - që do të nxiteshin nga moszgjedhja e presidentit apo presidentes së re para fundit të afatit kushtetues - janë "të evitueshme, të shmangshme dhe të panevojshme".

Por, ai shtoi se "pushteti ka 66 ulëse, dhe pa ta nuk bëhet kjo punë".

Mustafa tha se deri më tani nuk ka asnjë kandidaturë zyrtare që ka mbledhur të paktën 30 nënshkrime deputetësh dhe se mbetet e paqartë se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen, "E kam të pamundur të përgjigjem se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen. Mund të ketë sërish takim. Ne jemi të hapur, me shpresën që do të arrijmë një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit", tha

Mustafa.

Abdixhiku kishte theksuar se për LDK-në gara me disa kandidatë është "procedurë e paraparë për të dështuar" dhe mund të çojë vendin drejt zgjedhjeve të reja.

Nga ana tjetër, Kurti para takimit të 2 marsit kishte deklaruar se për zgjedhjen e presidentit "duhet dikush që i siguron 80 vota", pa përmendur emra konkretë.

Ai ka thënë më herët se Murat Jashari, djali i Rifat Jasharit dhe pjesëtar i familjes së Adem Jasharit, do të ishte figurë e përshtatshme për postin e presidentit, duke theksuar se vendit i duhet një personalitet që, sipas tij, "u bën ballë shtrëngatave" në rrethanat aktuale gjeopolitike. Megjithatë, Murat Jashari ka bërë të ditur se nuk ka ambicie për këtë pozitë.

Deri më tani nuk ka marrëveshje ndërmjet partive politike parlamentare për një emër konsensual për president të Kosovës, ndonëse janë dy ditët e fundit sipas afatit kushtetues kur vendi duhet të ketë president të zgjedhur. Në të kundërtën, automatikisht sipas Kushtetutës, Kosova shkon sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti që është edhe lideri i partisë më të madhe në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ditët e fundit zhvilloi disa takime me dy udhëheqësit e dy partive opozitare, Partisë Demokratike dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, por ai u shpreh skeptik nëse do të arrijnë një marrëveshje për gjetjen e një figure për president që do të kishte mbështetje të gjerë. Kurti tha se nuk i ka 80 votat e nevojshme për zgjedhjen e presidentit dhe se ajo çfarë mund të bëjë ai me numrat aktualë është t'i sigurojë nënshkrimet për dy kandidatë, ndonëse nuk përmendi emra. "Si Lëvizje Vetëvendosje ne kemi mundësi që ta nxjerrim një kandidat sepse i bëjmë 30

nënshkrime, aq sa nevojiten për të pasur kandidaturë. Bashkë edhe me pakicat që i kemi në mazhorancë mund t'i nxjerrim dy kandidatë. Për shkak se me 66 veta i kemi 60 nënshkrime. Tash edhe opozita, nëse nuk e përfshijmë Listën Serbe, janë 43 deputetë, 22 PDK-ja, 15 LDK-ja dhe 6 AAK-ja, gjithsej bëjnë 43. Pra edhe opozita mund të nxjerrë kandidat", tha Kurti, duke përmendur Kushtetutën e cila, sipas tij, e thotë qartë se "ne duhet të angazhohemi maksimalisht që të mos shkojmë në zgjedhje".

Duke e parë "rrezikun" real që Kosova të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, shumë organizata të shoqërisë civile u janë drejtuar me një letër publike partive politike parlamentare, nga të cilat kërkohet që të gjendet një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit dhe të shmangen zgjedhjet e sërishme. "Konsensusi për zgjedhjen e Presidentit është domosdoshmëri për stabilitetin institucional. Zgjedhjet e përsëritshme të parakohshme nuk duhet të konsiderohen si instrument për të garantuar funksionimin

NUK KA ZGJEDHJE TË REJA NË KOSOVË!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Javë interesante: Më 26 shkurt 2026 bëmë homazh te vandamshimi ku prehet Bacë Adem Demaçi. Një grup shokësh të Bacës që i qëndruam pranë Bacës deri kur u shndërrua në shpirt, në data të caktuara jemi aty ku duhet të jemi. Kësaj radhe homazhi, përkujtimi dhe nderimi u kurorëzua edhe me promovimin e një libri të Besim Baraliut, i dënuar politik dhe ushtar i UÇK-së, “Kohë pa Etos”, “Kohë pa Moral” që mrekullueshëm përshtatet me skuadrën e të pafytyrëve që e vodhën pushtetin mbi vuajtjet dhe gjakun tonë. Pjellë jugosllave, zgjatje biologjike e spiujve, udbashëve dhe lukunisë antikombëtare. Me këta Kurthi po e luan vallen e turpit, patriotët e dikurshëm sot janë nën “mriz të hijenave”, nuk i pyet kush për asgjë. Disa janë sistemuar në poste të falura dhe të kushtëzuara. Nga beteja në llogoret e Jugosllavisë dhe Serbisë u bënë figura shahu të andartes Mihali, njerka e madhe e LV-së dhe Nëna e madhe e Vorio Epirit. Ishim si grup; Dr. Hakiu, “mulla Idrizi”, Nuhi Llapqini, Elmiu, Fexha, Basri Rrumullaku, Besim Baraleci, Dr. Baliu, Duli ishte në Amerikë dhe unë - Qupina. Ishim edhe në promovimin e tre librave për Bacën Adem të përgatitura nga Selatin Novosella. Na mungoi

shumë Tahir Hani nga Veleshta e Strugës, një person i jashtëzakonshëm, si njeri dhe si shqiptar. Tash, edhe ai në amshim. Ndërroi jetë edhe një patriot i palëkundur - Mentor Kaçi. Albin Kurthi ishte në varrim, vetëm se nuk ia krisi vajit, si vajtuesit e Shkodrës. Kur Baca Adem iku në amshim, Albini ishte shumë më stoik, asnjë muskul nuk i lëvizte në fytyrë. Lëre më se mund t'i krise vajit ndonëse deklarohej si: “nxënës politik i Adem Demaçit”. Nuk është se Kurthi nuk ishte mërzhitur për Bacën por se i mbahej asaj se: “vaji i burrit është kënga...”. Mefistofeli!

Aktivitetet diplomatike: Qeveria Kurthi 2 ishte në karantenë, e izoluar nga ndërkombëtarët. Vojsa Osmani ishte e vetmja, sikur në kohën e pandemisë së Covid-it, që kishte leje speciale për të lëvizur në mbarë botën, me punë ose pa punë me para të shtetit. Këto lëvizje dhe takime, kryesisht korridoreve apo kulisave me personalitete të larta, të mesme apo të rënë për toke ndërkombëtare e shndërruan Kurthin në “mbajtës të qiririt Vjosës”, për t'i ndriçuar rrugën. Ndërkaq Kurthi, si lakuriq i natës e urren dritën! Prandaj deri sot ia “fiku dritat Vjosës” duke mos e rikandiduar për president!

Edhe Kurthi ka pasur takime diplomatike kryesisht me delikuentin seksual të Epstein, Miroslav Lajçakun. Lajçak seksualisht ka dhunuar “çupat e Epsteinit” kurse politikisht dhe strategjikisht e ka përdhunuar Kurthin dhe neve. Të gjithë ambasadorët vizituan qeverinë Kurthi 3. Fjala e parë ishte urimi për qeverinë kurse e dyta dhe shkak i vizitave ishte formimi i Zajebnicës dhe, siç thotë një mik imi i mirë, Agroni, formimi i Samoupravnicës (autonomisë politike dhe territoriale të serbëve në Kosovë)! Ky “urim” i ndërkombëtarëve është ankthi dhe makthi i Kurthit që e lë pa gjumë. E ka të qartë që nuk ka tjetër mundësi nëse do të qëndrojë në pushtet. Për këtë Kurthi e donte dikën - çdokënd nga familja Jashari për president që të mbulohej me qeben e autoritetit moral në kohën kur do të votohej Zajebnica dhe Samoupravnica. Para ndërkombëtarëve Kurthi ka pranuar çdo gjë para votuesve dhe jovotuesve fjalët janë më të fuqishme sa sakrifikimi i Oso Kukës në Kullë të Barotit! Prandaj është zbutur edhe me opozitën, me e nda përgjegjësinë për “lëshimin poshtë të brekusheve në Bruksel dhe Ohër ...”! Për kapitullim kombëtar dhe politik! Të gjitha bllokadat që i ka bërë Kurthi gjatë nëntë

muajve të kaluar ishin përpjekje të ikë dhe sabotojë zbatimin e marrëveshjeve, sikur djalli nga kryqi! I ka vetëm dy rrugë; ose do të kryqëzohet dhe gozhdohet si Krishti ose do të turpërohet si Pont Pilati! Përkthyer shqip: ose Hasan Prishtinë ose Esat Pashë Toptan! Vojsa Osmani, përmes Edvin Kristaq Ramës u bë anëtare e “Bordit të Paqes” e që e shashtisi Kurthin. Vojsa Osmani këtë e shfrytëzoi për të fituar edhe një mandat ndërsa Kurthi po e shfrytëzon për t'i shkurtuar mundësinë edhe për një mandat. Deri në orën 5 minuta para orës 12.00 kur sipas të gjitha gjasave do të detyrohet ta propozojë Vjosën edhe për një mandat tjetër. E që do të gëzojë shumë Berat Buzhalën, Zanën e “debateve televizive”, “rrugaçin e parë”, “avokatin dhunues”, nipin politik të Arkanit - “ekspertin e arsimit”, “hajnin e parave të Bacë Adem Demaçit - ekspert i arsimit” gjithashtu, “analist” nga Amerika dhe Gjermania që nuk e kanë të mbaruar as kursin e natës kundër analfabetizmit politik. Pas takimit me ambasadorë, Xhelali as me pshurrë nuk guxon më në Veri të Kosovës. Ia bënë të qartë se asnjë veprim që rrezikon sigurinë nuk mund të ndërmerret pa koordinim me ndërkombëtarët! Njëmend, a

nuk qenka çliruar veriu i Kosovës a? Albin Kurthi është aktivizuar shumë për Gazën, njëherë ndau 500.000 euro ndihmë, tash pasi ushtarët e KFOR-it i ka angazhuar si bedelë në Kosovë paska vendosur ta pajisë Izraelin me 5000 dronë kamikaz Skifter 1 prodhuar në Gjylekarë - Made in Kosova dhe 5000 të tjera Skifterë 2 prodhuar në Muçibabë, gjithashtu Made in Kosova. Ndërkaq, trupat paqeruajtëse nga Kosova që do të vendosen në Gazë do të udhëhiqen nga komandantë të shquar dhe trima të UÇK-së, Xhelal Sfeqla dhe Hysen Durmishi. Për çështje politike dhe morali janë caktuar Hekuran Murati - paramilitari dhe Dimal Basha - Arsovska. Mos ta lëmë Shvarc Donikën pa një angazhim dhe përgjegjësi. Assesi! Pasi Kurthi e bëri ministre të Drejtësisë, si e mençur që shitet e vërejtë se është në kundërshtim me ligjin ndarja e mjeteve për shpenzimet e shtetasve të Kosovës që Gjykata Raciste Speciale i akuzoi për pengim të drejtësisë. Tash, Shvarc Donika po kërkon “birat e gardhit” në këtë ligj që çlirimtarëve të dënuarve fillimisht t’ua ndalë bukën pastaj ujin e së fundi edhe ajrin! Vetëm kështu do të pranonte se ligji po zbatohet, krejt dhe drejt!

e institucioneve, por, përkundrazi, ato e rrisin pasigurinë dhe dëmtojnë vazhdimësinë institucionale. Një President i zgjedhur me konsensus ofron stabilitet, siguron funksionimin normal të pushteteve dhe rrit besimin qytetar në institucionet e shtetit”, thuhet, mes tjerash, në letrën e publikuar nga shoqëria civile.

Presidentja aktuale, Vjosa Osmani, ka shprehur dëshirën për një mandat të dytë, por Lëvizja Vetëvendosje, që e kishte propozuar në mandatin e parë, nuk e ka përmendur emrin e saj si kandidate. Partitë opozitare e kanë kritikuar Osmanin për, siç kanë thënë, njëanshmëri në favor të Qeverisë. Në javët e fundit, gatishmëri

për kandidim ka shprehur edhe ish-ministri Arsim Bajrami, ndonëse pa mbështetje të qartë nga partitë tjera. Parlamenti i Kosovës duhet të zgjedhë presidenten apo presidentin e vendit më së largu deri më 05.03, pra jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentes aktuale, Vjosa Osmani, mandati i së cilës

përfundon më 4 prill 2026. Për të garuar për president të vendit, një kandidati i duhet t'i sigurojë të paktën 30 nënshkrime të deputetëve, ndërsa nevojiten dy të tretat e votave në Kuvendin e Kosovës me 120 deputetë për t'u zgjedhur president. Kuorumi në Kuvend arrihet me 80 deputetë, ndërsa, nëse në dy rundet e para të votimit një

kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t'i ketë 61 sosh. Dështimi eventual për ta zgjedhur presidenten apo Presidentin e ri të Kosovës deri më datën 05.03 do ta fuste vendin sërish në një krizë të re politike, duke e çuar Kosovën në zgjedhje të parakohshme parlamentare për herë të dytë brenda pak muajsh.

Ulen të hyrat e Qeverisë

PRISHTINË, 3 MARS - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Llogaritë Qeveritare për periudhën TM4 2025. Ky publikim paraqet pasqyrën e të

hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

Gjithsej të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme në TM4 2025 ishin 920.4 milionë

euro, ndërsa të hyrat në TM4 2024 ishin 941.6 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë: Tatimet në produkte (70,7 %); Tatimet

rrjedhëse në të ardhura (14,0 %); Aktivitet dhe detyrimet financiare (6,2 %). Ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.



THELLOHET BASHKËPUNIMI NDËRMJET BIK-ut DHE DIJANET-it TË TURQISË

PRISHTINË, 3 MARS - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim zyrtar kryetarin e DIJANET-it të Turqisë, prof. dr. Safi Arpagu. Gjatë takimit, myftiu Tërnavë theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer vëllazëror ndërmjet dy institucioneve dhe dy popujve, duke e cilësuar atë si një model të mirëkuptimit dhe solidaritetit të ndërsjellë. Ai shprehu falënderim të veçantë për mbështetjen e DIJANET-it në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë, restaurimin e disa xhamive në Kosovë, si dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm në fushën e mësim-besimit. Myftiu Tërnavë gjithashtu shprehu gatishmërinë për realizimin e projekteve të reja të



përbashkëta në frymën vëllazërore, për të mirën e besimtarëve myslimanë dhe forcimin e mëtejme të lidhjeve institucionale.

Nga ana tjetër, kryetari i DIJANET-it të Turqisë, dr. Arpagu, falënderoi myftiun e Kosovës për punën dhe

angazhimin e tij të palodhshëm. Ai vlerësoi lart institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe rolin e myftiut Tërnavë në ruajtjen e traditës islame, kultivimin e vlerave fetare dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet BIK-ut dhe DIJANET-it të Turqisë.

Arta Vokshi - Nallbani riemërohet drejtoreshë e Urbanizmit në Pejë

PEJË, 3 MARS - Arta Vokshi - Nallbani është riemëruar drejtoreshë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Pejë.

Ajo edhe në mandatin e kaluar ka qenë në këtë pozitë.

Arta Vokshi - Nallbani ka shkruar në "Facebook" se me përkushtim edhe në këtë mandat do të vazhdojë me të njëjtin seriozitet, transparencë dhe përkushtim ndaj qytetit të Pejës. "Sot u riemërova edhe një herë Drejtoreshë e

Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pas përfundimit të një mandati 4-vjeçar plot punë dhe përgjegjësi. Falënderuese për besimin e dhënë nga kryetari i degës së Partisë Demokratike, z. Xhavit Haliti dhe kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri. E përkushtuar që edhe në këtë mandat të vazhdoj me të njëjtin seriozitet, transparencë dhe përkushtim ndaj qytetit tonë", ka shkruar ajo.



MINISTRI HOTI MERR VENDIM PËR THEMELIMIN E KATËR KOMISIONEVE

PRISHTINË, 3 MARS - Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka njoftuar ka marrë vendim për themelimin e katër komisioneve me qëllim garantimin e trajtimit të drejtë dhe ligjor të çdo kërkesë për ankesë. "Në përputhje me legjislacionin në fuqi, kam marrë vendim për themelimin e katër komisioneve nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, me qëllim garantimin e trajtimit të drejtë dhe ligjor të çdo kërkesë dhe ankese: 1. Komisioni i Ankesave për shtesat e fëmijëve dhe shtesat për lehonë; 2. Komisioni i Ankesave për ndihmën sociale; 3. Komisioni zbatues për shqyrtimin e kërkesave nga programi pilot SAS; 4. Komisioni i Ankesave për programin pilot SAS. Çdo qytetar



që konsideron se i është cenuar e drejta, ka adresë institucionale për ta kërkuar drejtësinë. Ftoj të gjithë që ankesat dhe kërkesat t'i drejtojnë pranë komisioneve përkatëse, në mënyrë që çdo rast të trajtohet me seriozitet dhe paanshmëri. Angazhimi im mbetet i qartë: trajtim i barabartë për secilin, zbatim strikt i ligjit dhe asnjë tolerim ndaj padrejtësive.

AKADEMIA E KOSOVËS DHE AJO E SHQIPËRISË KOORDINOHEN PËR BASHKËPUNIM

PRISHTINË, 3 MARS - Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) në përbërje të akademikes Justina Shiroka-Pula kryetare, akademik Bardh Rugova sekretar shkencor dhe akademik Frashër Demaj sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore në shoqërimin e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Vasil S. Tole, zhvilloi



një takim me kryetarët e komisioneve dhe njëjseve përkatëse të institucionit. Në fokus të takimit ishte

konfirmimi i vullnetit të ndërsjellë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy akademive, forcimi i koordinimit institucional dhe rritja e kontributit të tyre në zhvillimin shkencor, arsimor dhe shoqëror në hapësirën shqiptare. Takimi shërbeu për një njohje më të mirë me strukturat që punojnë pranë ASHSH-së e me fushat e tyre të interesit.

Kompletohet ekzekutivi i komunës së Gjilanit, emërohet edhe drejtori i Arsimit

GJILAN, 3 MARS - Është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Gjilanit, ku ndër të tjera u prezantua edhe drejtori i ri i Arsimit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit,

Alban Hyseni, tha se Jeton Rexhepi i është bashkuar ekipit të tij qeverisës në krye të Drejtorisë së Arsimit, me angazhim për të avancuar cilësinë në arsim dhe për të

çuar përpara reformat e nevojshme në këtë sektor kyç për zhvillimin e qytetit tonë. "Na presin shumë projekte dhe punë konkrete në shërbim të nxënësve, mësimeve të



NGA LINDJA E MESME DERI NË KOSOVË: SI U BË BONDSTEEL TEMË PAS NGJARJEVE NË IRAN?

PRISHTINË, 3 MARS - “Mos e gjyko, godite Bondsteel-in” ose “Ja edhe një bazë amerikane! Faleminderit paraprakisht”, janë disa nga komentet që qarkullojnë në kanalet e aplikacionit Telegram dhe në rrjete të tjera sociale që nga 28 shkurti, kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli i nisën sulmet kundër Iranit.

Kampi Bondsteel, i cili ndodhet pranë Ferizajt në Kosovë, është baza më e madhe ushtarake amerikane në Ballkan, raporton Radio Evropa e Lirë.

Në disa grupe në Telegram, të cilat kanë nga 10.000 deri mbi 80.000 ndjekës, publikohen edhe harta me vendndodhjen e shënuar të Bondsteel-it, të shoqëruara me komente si “Ky është kërcënimi më i madh për Iranin aktualisht”, ose harta të rrezes së raketave balistike iraniane me fokus në Kosovë, me përshkrimin “Thjesht bëje”. Një nga kanalet më të vizituara të ekstremit të djathtë në Serbi në Telegram, “Bunt je stanje duha”, më 1 mars publikoi edhe koordinatat e kampit Bondsteel në Kosovë me tekstin: “Thonë se ne jemi ata ekstremistët dhe se duhet të na vijë turp që duam ta shohim Bondsteel-in në flakë”.

Ky postim deri në publikimin e tekstit kishte pothuajse 18.000 shikime.

Ndryshe, shumica e kanaleve në Telegram në gjuhën serbe janë krijuar pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, ndërsa postimet janë qartazi proruse, duke kritikuar ashpër çdo bashkëpunim me vendet perëndimore.

Në tri ditët e fundit ato po ndjekin në kohë reale edhe zhvillimet në Lindjen e Mesme. Ndërkohë, administratorët e



kanalit “Koridor”, i cili ka 11.000 ndjekës, theksuan në një postim në Telegram se nuk do të “transmetojnë lajme për këtë luftë nëse nuk ka ndonjë lajm domethënës, si për shembull që është goditur Bondsteel, sepse, thjesht, si njëra palë, ashtu edhe tjetra kanë vlarë serbë, kështu që me gjithë zemër dëshirojmë të zhduken të dyja palët”.

Më herët edhe në këtë kanal janë publikuar koordinatat e kampit Bondsteel me përshkrimin: “Koordinata për iranianët, këtu jeton [kryeministri izraelit Benjamin] Netanyahu dhe të gjithë armiqtë tuaj”.

Të dielën në mbrëmje u shpërndanë sërish të njëjtat koordinata, së bashku me një fotografi të rrezes së raketave balistike iraniane dhe me komentin: “Nuk e arrini dot, apo? Hajde pra, ta shohim”.

Kanali në Telegram “Koridor” më herët është përdorur nga “Brigada sever”, e cila së bashku me Mbrojtjen Civile është shpallur organizatë terroriste nga Qeveria e Kosovës në

qershor 2023.

Të njëjtat koordinata të kampit Bondsteel ose thirrje për bombardimin e tij i kanë publikuar edhe kanale të tjera proruse të djathta, si “Сербский Вестник”, Srpska Sparta Info dhe Bunker. Të gjitha së bashku kanë mbi 50.000 ndjekës.

Përveç në Telegram, koordinatat e bazës ushtarake amerikane në Kosovë janë shpërndarë edhe në rrjetet sociale Facebook dhe X. Kështu, postimi ka përfunduar edhe në grupin “Srbi i Rusi, braća zauvek”, i cili ka rreth 30.000 ndjekës, si dhe në grupin “Pravoslavni manastiri i crkve”, që ndiqet nga 70.000 persona. Ndryshe, për shumicën e kanaleve të djathta dhe proruse, Kosova është temë e përbashkët - përkatësisht narrativi i delegitimimit të institucioneve të Kosovës, mohimi i pavarësisë së Kosovës, si dhe promovimi i retorikës radikale si thirrjet për ndërhyrje ushtarake.

Pra, në tri ditët e fundit, përveç thirrjeve për bombardimin e

Bondsteel-it, mund të shihen edhe mesazhe se “duhet shfrytëzuar rasti dhe të kthehet ajo që është marrë me forcë”.

Jeta Loshaj, hulumtuese e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, e cila ndjek edhe rrjedhën e dezinformatave në kanalet e Telegramit, thotë se postimet e ditëve të fundit nuk përbëjnë kërcënim real nga pikëpamja ushtarake dhe teknike, pasi Irani nuk ka armë me rreze aq të gjata sa për ta synuar Kosovën apo pjesë më të gjera të Evropës.

Megjithatë, ajo thekson se thirrjet e orkestruara për bombardimin e Bondsteel-it përputhen me “modelin tashmë të njohur të përforcimit të dezinformatave”. “Rrjetet proruse zakonisht shfrytëzojnë momentet e tensioneve të shtuara gjeopolitike, si përshkallëzimi i fundit që përfshin ShBA-në, Izraelin dhe Iranin, për të përhapur pretendime alarmuese, por të paverifikuara. Ballkani

Perëndimor, megjithëse nuk është arenë qendrore e këtyre konflikteve, mbetet një rajon i ndjeshëm dhe politikisht i brishtë. Për këtë arsye, shpesh bëhet objekt i narrativeve që synojnë të nxisin ankth, të thellojnë ndarjet brenda komuniteteve dhe të minojnë besimin në institucionet e sigurisë”, thotë Loshaj për Radion Evropa e Lirë.

Ajo shton se ndikimi i mesazheve të tilla është psikologjik dhe politik. “Shpërndarja e qëllimshme e koordinatave dhe kornizimi dramatik i mesazheve synojnë të nxisin shqetësim dhe të for-

cojnë perceptimin e paqëndrueshmërisë në këtë pjesë të Evropës”, shton ajo.

Megjithatë, ajo thekson se publikimet zinxhir në kanalet e Telegramit nuk duhen neglizhuar plotësisht. “Për këtë arsye, në koordinim me KFOR-in, institucionet e Kosovës duhet të vlerësojnë rregullisht cenueshmërinë e mundshme, përfshirë shqyrtimin e forcimit të kapaciteteve mbrojtëse në afatgjatë. Kosova aktualisht nuk posedon sisteme të veta të mbrojtjes kundërajrore dhe, megjithëse nuk ka kërcënim të menjëhershëm, planifikimi strategjik i kapaciteteve të ardhshme mbrojtëse përbën një arsye legjitime që të fillohet të mendohet për këtë qysh tani”, thotë Loshaj.

Më herët, Ivana Stradner, bashkëpunëtore e Fondacionit joqeveritar për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington, në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë ka vlerësuar se pasojat e narrativit radikal prorur në kanalet e Telegramit tashmë janë të dukshme në vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi prej vitesh ato përhapin në mënyrë aktive propagandë antiperëndimore duke polarizuar shoqëritë. Si shembull, ajo përmendi se një numër i madh i qytetarëve të Serbisë janë kundër BE-së, edhe pse pikërisht BE-ja ofron ndihmë të madhe për atë vend.

Ajo theksoi gjithashtu se kanalet proruse në Telegram në gjithë rajonin luajnë rol të rëndësishëm jo vetëm për shkak të numrit të ndjekësve, por edhe sepse shërbejnë si “nyje hyrëse në hapësirën informative”.

Çfarë po ndodh në Lindjen e Mesme?

ShBA-ja dhe Izraeli më 28 shkurt nisën një operacion ndaj objektivave të rëndësishme në Iran, përfshirë objekte ushtarake iraniane dhe rezidenca të zyrtarëve më të lartë të vendit.

Në këtë operacion, të cilit i parapriu disa javë tensionesh

dhe grumbullim i përshpejtuar i forcave ushtarake amerikane, u vra udhëheqësi suprem iranian, ajatollah Ali Khamenei. Presidenti amerikan Donald Trump deklaroi gjithashtu se 48 liderë iranianë u vranë në sulme, si dhe se sulmet mund të zgjasin katër javë.

Nga ana tjetër, Irani nisi sulme ndaj objekteve ushtarake amerikane dhe perëndimore si dhe ndaj lokacioneve civile në Izrael, Gjirin Persik dhe vende të tjera, ndërsa Izraeli iu kundërpërgjigj me sulme ndaj pozicioneve të Hezbollahut në Liban.

BE-ja do të vazhdojë të mbështesë reformën gjyqësore

PRISHTINË, 3 MARS - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, ka takuar kryetarin në largim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj. Orav shprehu vlerësimin e tij

për kontributin e Zogajt në reformën gjyqësore, në përputhje me angazhimet e Kosovës për Sundimin e Ligjit, duke theksuar nevojën që udhëheqja e re e Këshillit të

vazhdojë të punojë në të njëjtën rrugë drejt një sistemi drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas. Si partneri më i besueshëm i Kosovës dhe ofruesi më i

madh i ndihmës financiare, BE-ja do të vazhdojë të mbështesë reformën gjyqësore nëpërmjet financimit të ri IPA (15 milionë euro) dhe Planit të Rritjes.



BE-ja i ka dhënë 300 milionë euro Kosovës vetëm në grante nga WBIF

PRISHTINË, 3 MARS - Korniza e BE-së për Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) po i shndërron investimet në rezultate reale për qytetarët e Kosovës. Si partneri më i fortë dhe ofruesi më i madh i ndihmës financiare, BE-ja i ka dhënë pothuajse 300 milionë euro Kosovës vetëm në grante nga WBIF, duke u siguruar 550,000 qytetarëve qasje në ujë të pijshëm të sigurt, duke rehabilituar ngrohjen qendrore për 13,500 qytetarë në Prishtinë

dhe duke ofruar 19 MW kapacitet gjenerimi të energjisë së rinovueshme dhe 169 ndërtesa publike me efikasitet energjetik. Hubert Perr, shefi i Sektorit të Bashkëpunimit të BE-së në Kosovë, iu bashkua të martën përfaqësuesve të qeverisë, institucioneve financiare dhe ekspertëve në tryezën e rrumbullakët të Institutit Riinvest për të diskutuar WBIF dhe mbështetjen e tij të mëtejshme për të ardhmen

evropiane të Kosovës. Tryeza e rrumbullakët, e mbështetur nga projekti “Përgjigje Politike” i financuar nga BE-ja në kuadër të programit Horizon Europe, shërbeu për të forcuar koordinimin në përgatitjen e projekteve dhe për të shfrytëzuar më mirë Planin e Rritjes së BE-së për një ndikim më të madh. Në takim u tha se diskutimet do të formësojnë rekomandimet e politikave për të rritur angazhimin e Kosovës me WBIF.



BQK-ja FORCON RRUGËN E SAJ DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

PRISHTINË, 3 MARS - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka mirëpritur lansimin e Fazës III të “Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor”, të financuar nga BE, i cili zbatohet bashkërisht nga banka qendrore e Gjermanisë (Deutsche Bundesbank), 19 banka qendrore të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ) dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE).

I financuar nga Bashkimi Evropian me 3 milionë euro në kuadër të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA III), programi 36-mujor



synon të avancojë kapacitetet analitike, rregullative dhe mbikëqyrëse të bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse në gjithë Ballkanin

Perëndimor. Për BQK-në, kjo nismë ofron mbështetje teknike të synuar për forcimin e instrumenteve të politikave, kornizave rregullative

dhe praktikave operacionale, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane. Si institucion përfitues, BQK-ja do të angazhohet në mënyrë aktive në një program intensiv rajonal trajnimi dhe në masa të asistencës teknike dypalëshe të përshtatura sipas prioriteteve të saj institucionale. Programi do të fokusohet në fusha kyçe strategjike të bankës qendrore, përfshirë parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT), qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve kibernetike, shkencën dhe qeverisjen e të dhënave, transformimin digjital, inovacionin dhe përdorimin e

përgjegjshëm të inteligjencës artificiale në bankat qendrore. Përmes pjesëmarrjes së saj në këtë program, BQK-ja rikonfirmon angazhimin për forcimin e stabilitetit financiar, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe modernizimin e kornizës së saj institucionale në përgatitje për integrim më të thellë evropian. Programi mbështet më tej objektivin e BQK-së për përafrimin e praktikave rregullative dhe mbikëqyrëse me acquis communautaire dhe standardet e SEBQ-së, duke nxitur njëkohësisht partneritete të qëndrueshme me institucionet homologe në të gjithë Bashkimin Evropian.

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS: STABILITETI POLITIK, KUSHT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

PRISHTINË, 3 MARS - Oda Ekonomike e Kosovës, e cila drejtohet nga Lulzim Rafuna, ka shprehur shqetësimin lidhur me situatën aktuale politike në vend dhe mundësinë e organizimit të zgjedhjeve të reja, duke theksuar se ekonomia e vendit ka nevojë për stabilitet dhe institucione funksionale.

Në një thirrje publike drejtuar partive politike parlamentare në Republikën e Kosovës, Oda Ekonomike vlerëson se në këtë fazë të ndjeshme të zhvillimit ekonomik, vendi ka nevojë për vendimmarrje të qëndrueshme dhe bashkëpunim institucional, e jo për procese të reja zgjedhore që mund të thellojnë pasigurinë ekonomike dhe institucionale. “Oda u bën thirrje subjekteve

politike që të gjejnë gjuhë të përbashkët dhe të shmangin dërgimin e vendit në zgjedhje, duke nënvizuar se stabiliteti politik është parakusht për stabilitetin ekonomik. Sektori privat në Kosovë mbetet veçanërisht i ekspozuar ndaj luhatjeve ekonomike ndërkombëtare, për shkak të varësisë së lartë nga importi. Zhvillimet globale dhe rajonale mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në çmime, në zinxhirët e furnizimit dhe në nivelin e investimeve, duke rritur pasigurinë në treg”, thuhet në reagimin e OEK-ut. Oda ekonomike tutje thekson se vendi ka nevojë për investime dhe reforma strukturore. “Oda Ekonomike vlerëson se vendi ka nevojë urgjente për rritje të



investimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe për reforma të thella strukturore që do ta bënin Kosovën më konkurruese dhe më tërheqëse për biznes.

Në kontekstin e zhvillimeve gjeopolitike dhe rreziqeve të mundshme për rritje të çmimeve apo çrregullime në zinxhirin e furnizimit, kërkohet që Qeveria

dhe Kuvendi të jenë të përgatitur me një paketë të qartë mbështetëse për bizneset dhe konsumatorët”, thuhet në njoftim.

OEK-u po ashtu bën thirrje për komunikim të matur. “Oda u bën apel bizneseve dhe opinionit publik që të tregojnë kujdes ndaj lajmeve të paverifikuara, të cilat mund të shkaktojnë panik dhe të ndikojnë negativisht në funksionimin e tregut. Në përfundim, në emër të sektorit privat, Oda Ekonomike e Kosovës kërkon maturi politike, dialog konstruktiv dhe përgjegjësi shtetërore në funksion të zhvillimit ekonomik afatgjatë të vendit”, thuhet në reagimin e Odës Ekonomike të Kosovës.

Nënshkruhet marrëveshja e partneritetit për projektin “Connecting Kosovo Businesses with Diaspora”

PRISHTINË, 3 MARS - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka nënshkruar marrëveshjen e partneritetit me Caritas Switzerland in Kosovo, në kuadër të projektit “Connecting Kosovo Businesses with Diaspora”. Marrëveshja u nënshkrua nga

kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna dhe Astrid Wein, drejtoreshë e Caritas-it Zviceran në Kosovë. Ky partneritet synon forcimin e lidhjeve ndërmjet bizneseve kosovare dhe diasporës, duke krijuar ura bashkëpunimi, mundësi investimi dhe

zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për vendin. OEK-u ka theksuar se mbetet e përkushtuar në mbështetjen e sektorit privat dhe në zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.



GODITJE MË FORT SE SHPEJTËSIA E MENDIMIT. LUFTA NDAJ IRANIT ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE



Përdorimi i mjeteve për luftë me inteligjencë artificiale për të mundësuar sulmet ndaj Iranit po paralajmëron një epokë të re bombardimesh më të shpejta se “shpejtësia e mendimit”, kanë deklaruar ekspertët, mes frikës se vendimmarrësit njerëzorë mund të anashkalohen. Modeli i AI i kompanisë Anthropic, Claude, raportohet se është përdorur nga ushtria amerikane gjatë valës së sulmeve, pasi teknologjia “shkurton zinxhirin e vrasjeve”, pra procesin nga identifikimi i objektivit, te miratimi ligjor dhe deri te lëshimi i goditjes. SHBA dhe Izraeli, të cilët më parë kishin përdorur AI për identifikimin e objektivave në Gaza, ndërmorën pothuajse 900 sulme ndaj objektivave iraniane vetëm në 12 orët e para. Gjatë këtyre sulmeve, sipas raportimeve, raketat izraelite vranë udhëheqësin suprem të Iranit, Ali Khamenei.

Lufta me Inteligjencë Artificiale shkurton kohë

Akademikët që studiojnë këtë fushë thonë se AI po shkurton ndjeshëm kohën e planifikimit për sulme komplekse, një

fenomen i njohur si “kompresim i vendimit”. Disa paralajmërojnë se kjo mund të çojë në një situatë ku ekspertët ushtarakë dhe ligjorë thjesht vulosin formalisht plane sulmi të krijuara nga sisteme të automatizuara. Në vitin 2024, Anthropic vendosi modelin e saj në Departamentin Amerikan të Luftës dhe në agjenci të tjera të sigurisë kombëtare për të përshpejtuar planifikimin ushtarak. Claude u bë pjesë e një sistemi të zhvilluar nga kompania e teknologjisë ushtarake Palantir Technologies, në bashkëpunim me Pentagonin, për të “përmirësuar në mënyrë dramatike analizën e inteligjencës dhe për të ndihmuar zyrtarët në proceset e vendimmarrjes”. Craig Jones, pedagog i lartë në gjeografinë politike në Universitetin e Newcastle dhe ekspert i “zinxhirëve të vrasjes”, tha: “Makina e AI po bën rekomandime për objektivat, gjë që në disa aspekte është më e shpejtë se vetë shpejtësia e mendimit. Ke shkallëzim dhe shpejtësi njëkohësisht: po kryen goditje të stilit atentat ndërsa

paralizon aftësinë e regjimit për t’u kundërpërgjigjur me raketa balistike ajrore. Kjo në luftërat historike mund të kishte zgjatur ditë ose javë. Tani po bëhet gjithçka njëherësh.”

Si funksionon sistemi


Sistemet më të fundit të AI analizojnë me shpejtësi sasi të mëdha informacioni mbi objektiva të mundshëm: pamje nga dronët, përgjime telekomunikimi, si dhe inteligjencë njerëzore. Sistemi i Palantir përdor mësimin makinerik për të identifikuar dhe priorizuar objektivat, për të rekomanduar llojin e armëve, duke marrë parasysh rezervat dhe performancën e mëparshme kundër objektivave të ngjashëm. Ai përdor gjithashtu arsytim të automatizuar për të vlerësuar bazën ligjore të një sulmi. David Leslie, profesor i etikës, teknologjisë dhe shoqërisë në Queen Mary University of London, e cilësoi këtë si “epokën e re të strategjisë dhe teknologjisë ushtarake”. Por ai paralajmëroi për rrezikun e “shkarkimit kognitiv”: njerëzit që marrin vendimin përfundimtar mund të ndihen

të shkëputur nga pasojat, sepse përpjekja analitike është bërë nga makina. Të shtunën, 165 persona, shumë prej tyre fëmijë, u vranë në një sulm me raketa që goditi një shkollë në jug të Iranit, sipas mediave shtetërore. Objekti ndodhej pranë një kazerme ushtarake dhe OKB e quajti sulmin “një shkelje të rëndë të ligjit humanitar”. Ushtria amerikane deklaroi se po heton raportimet.

Gara globale për Inteligjencë Artificiale ushtarake

Nuk dihet se çfarë sistemesh AI, nëse ka, ka integruar Irani në makinerinë e tij ushtarake, ndonëse në vitin 2025 pretendoi se përdorte AI në sistemet e drejtimit të raketave. Programi i tij i AI, i penguar nga sanksionet ndërkombëtare, duket i papërfillshëm krahasuar me superfuqitë si SHBA dhe Kina. Në ditët para sulmeve ndaj Iranit, administrata amerikane kishte deklaruar se do ta përjashtonte Anthropic nga sistemet e saj pasi kompania refuzoi të lejonte përdorimin e

AI për armë plotësisht autonome ose për mbikëqyrje të qytetarëve amerikanë. Megjithatë, sistemi mbetet në përdorim derisa të zëvendësohet. Ndërkohë, rivali i saj OpenAI nënshkroi një marrëveshje me Pentagonin për përdorim ushtarak të modeleve të tij. “Avantazhi qëndron në shpejtësinë e vendim-marrjes, në kompresimin e planifikimit nga ditë apo javë në minuta ose sekonda,” tha Leslie. “Këto sisteme prodhojnë opsione për vendim-marrësit njerëzorë, por ata kanë një dritare shumë më të ngushtë kohore për të vlerësuar rekomandimet.” Prerana Joshi, studiuese në Royal United Services Institute, shtoi se përdorimi i AI po zgjerohet në të gjitha aspektet e mbrojtjes: logjistikë, trajnim, menaxhim vendimesh dhe mirëmbajtje. “AI është një teknologji që u lejon vendimmarrësve të përmirësojnë produktivitetin dhe efikasitetin. Ajo sintetizon të dhënat me një ritëm shumë më të shpejtë, në mënyrë që të ndihmojë procesin e vendimit,” tha ajo. / The Guardian – Bota.al



Sot dhe nesër mbahet turneu tradicional i volejbollit që nderon "Epopenë e UÇK"-së



PRISHTINË, 3 MARS - Sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) do të organizohet turneu tradicional i volejbollit në kuadër të aktiviteteve për shënimin e "Epopesë së UÇK"-së, një ngjarje që kombinon sportin me kujtesën dhe respektin për

sakrificën e heronjve. Turneu do të nis sot në orën 11:00 me hapjen zyrtare, ndërsa ndeshjet e para fillojnë në orën 12:00. Në këtë ditë do të garojnë skuadrat: KV Partizani (Tiranë), KV Teuta (Durrës), KV Ferizaj, KV Drita (Gjilan), KV Fushë Kosova dhe

KV Skenderaj, nikoqiri dhe organizatori i turneut. Ndërsa nesër (e enjte), aktiviteti nis në orën 11:00 me homazhe në kompleksin memorial "Adem Jashari", ku të gjitha ekipet pjesëmarrëse do të nderojnë heronjtë e UÇK-së. Në orën 13:00 do të zhvillohen

gjysmëfinalët dhe finalja e turneut, duke vendosur fituesin e këtij edicioni. Turneu mbahet me mbështetjen e Federatës së Volejbollit të Kosovës dhe është pjesë e kalendarit zyrtar të aktiviteteve përkujtimore të "Epopesë së UÇK-së".

ADEMI DHE IDRIZI DISKUTOJNË PËR PROJEKTE TË PËRBASHKËTA SPORTIVE NË VUSHTRRI

PRISHTINË, 3 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, me të cilin ka biseduar rreth bashkëpunimit në fushën e infrastrukturës sportive. Ademi është shprehur i bindur

se përmes këtij bashkëpunimi do të realizojnë iniciativa konkrete në të mirë të komunitetit dhe zhvillimit të futbollit në Vushtri. "Diskutuaam për projekte të përbashkëta që synojnë përmirësimin e kushteve për sportistët dhe të rinjtë, si dhe

krijimin e hapësirave më moderne sportive në këtë komunë. Jam i bindur se përmes këtij bashkëpunimi do të realizojmë iniciativa konkrete në të mirë të komunitetit dhe zhvillimit të futbollit në Vushtri", ka shkruar Ademi në "Facebook".



DERBI PEJA - TREPÇA NDEZ JAVËN E 22-të NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË BASKETBOLL



ProCredit Superliga e Kosovës në basketboll rikthehet në aksion me ndeshjet e javës së 22-të, që pritet të sjellin përballje mjaft interesante dhe të rëndësishme për renditjen tabelare. Vëmendja kryesore është te derbi ndërmjet GO+ Pejës dhe Trepçës, e cila

zhvillohet sot (e mërkurë). Pejanët numërojnë dhjetë fitore e 11 humbje këtë edicion, ndërsa mitrovicasit kryesojnë renditjen me 18 fitore e vetëm tri humbje, duke hyrë në këtë sfidë si liderë të kampionatit. Ndeshje me peshë zhvillohet edhe në Rahovec, ku Rahoveci

029 përballlet me Borën. "Vreshtarët" renditen në vendin e tetë me shtatë fitore e 14 humbje, ndërsa skuadra nga Prishtina është e treta me 11 fitore e dhjetë humbje. Ndërsa për nesër (e enjte) në program janë dy takime të tjera. Bashkimi pret Vëllaznimin, me

prizrenasit që kanë 11 fitore e shtatë humbje, ndërsa kuqezinjtë tetë fitore e 13 humbje. Ndërkohë, Sigal Prishtina përballlet me Golden Eagle Yllin, dy skuadra që këtë edicion kanë regjistruar nga tetë fitore e 13 humbje dhe synojnë rikthimin te rezultatet pozitive.

FUTBOLLI PO NDRYSHON, MIRATOHEN RREGULLAT E REJA KUNDËR HUMBJES SË KOHËS

HENSOL, 3 MARS - Bordi i Shoqatës Ndërkombëtare të Futbollit (IFAB) ka miratuar një paketë rregullash të reja me synim përshtetshmëri dhe ritmit të ndeshjeve dhe luftimit të humbjes së kohës, të cilat do të hyjnë në fuqi në Kupën e Botës 2026 dhe në të gjitha garat e tjera nga 1 korriku i këtij viti. Vendimi është marrë në mbledhjen e 140-të të

përgjithshme vjetore të IFAB -it në Hensol të Uellsit. Ndër ndryshimet kryesore është prezantimi i një numërimi mbrapsht prej pesë sekondash për rivëniet anësore dhe goditjet nga porta. Nëse gjyqtari vlerëson se rifillimi i lojës po vonohet qëllimisht, do të nisë numërimi vizual dhe nëse topi nuk vihet në lojë brenda afatit, posedimi do t'i kalojë

kundërshtarit. Po ashtu, lojtarët e zëvendësuar do të kenë vetëm 10 sekonda për të lënë fushën, në të kundërtën, zëvendësuesi do të duhet të presë deri në ndërprerjen tjetër pas një minute loje. IFAB-i ka vendosur gjithashtu që lojtarët që marrin trajtim për lëndime në fushë të dalin jashtë për një minutë pas rifillimit të lojës, për të shmangur vonesat taktike. Janë

miratuar edhe tri ndryshime në protokollin e VAR-it, duke lejuar ndërhyrje në rastet e kartonëve të kuq që burojnë nga një karton i dytë i verdhë i pasaktë, identitetit të gabuar dhe goditjeve nga këndi të dhëna qartësisht gabim. Edicioni i ri i "Rregullave të Lojës" do të lejojë gjithashtu përdorimin e sendeve jo të rrezikshme nëse janë të mbuluara në mënyrë të

sigurt dhe do t'u japë gjyqtarëve mundësinë të mbajnë kamera të montuara në trup. Janë bërë edhe sqarime lidhur me topat e humbur dhe preket e dyfishta aksidentale gjatë penalltive, ndërsa IFAB-i ka rënë dakord të hapë konsultime për raste të largimit të lojtarëve si formë proteste dhe për mbulimin e gojës gjatë komunikimit në fushë.

Mbappe jashtë fushe për kohë të pacaktuar

MADRID, 3 MARS - Real Madridi ka konfirmuar se sulmuesi Kylian Mbappe, ka udhëtuar për në Francë për teste të mëtejshme, me qëllim të vlerësimit të progresit të dëmtimit të gjurit të tij. "Pas testeve të kryera nga specialistë

francezë, nën mbikëqyrjen e shërbimeve mjekësore të Real Madridit, është konfirmuar diagnoza e një shtrembërmi në gjurin e majtë të Mbappe. Po ndiqet trajtim konservativ dhe progresi i tij do të monitorohet vazhdimisht", ka njoftuar Real

Madridi. I pyetur nga mediet, trajneri Alvaro Arbeloa, ka theksuar se nuk do të jepen afate për kthimin e Mbappe, edhe pse sipas analizave të para, mungesa do të shkojë deri në tri javë. Trajneri spanjoll ka nënvizuar se shqetësimi ka filluar më 7

dhjetor kundër Celta Vigo dhe që nga atëherë e ka penguar atë të luajë në maksimum. Mbappe pritet të kthehet në ndeshjen kthyese të 1/8 së finales të Ligës së Kampionëve, që Real Madridi e luan kundër Manchester Cityt.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Alkoslab” SH.P.K. pronar Islam Zuzaku me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811452622 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Alkoslab” D.O.O. Islam Zuzaku Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811452622 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Alkoslab” L.L.C. with owner Islam Zuzaku with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811452622 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bar Restaurant Crystal Pone B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811833666 të lëshuar nga MTI e Kosovës.

- VK Kabashi SH.P.K. shpall të pavlefshme nurin Unik Identifikues 812173110 të lëshuar nga ARBK.

- Market AM SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 812121177 të lëshuar nga ARBK.

- Auto Shkolla “Trimi” SH.P.K. ka nisur një ofertë të veçantë me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

- Gjatë gjithë muajit mars, të gjitha gratë do të përfitojnë 40% zbritje në regjistrim dhe shërbimet e auto shkollës.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

